



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 3 dhe 18, dhe në pajtim me nenin 7 paragrafi 1 pika 4, neni 24 dhe 41 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

POLITIKA PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E POLITIKËS PËR MENAXHIM DHE INVESTIME TË REZERVAVE VALUTORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

1. Në Politikën për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 223/15 dhe 141/16) në të gjithë tekstin fjalët: "Republika e Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët: "Republika e Maqedonisë së Veriut".

2. Në pikën 4, paragrafi 4, alinea 3 ndryshohet dhe thotë:

"Portofoli i investimeve, i cili mund të ketë periudhë investimi më shumë se një vit dhe që menaxhohet për shkak të rritjes së kthimit të rezervave valutore, si dhe për mbulimin e detyrimeve të paparashikuara në afat më të gjatë për shkak të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik dhe financiar të vendit. Ky portofol investohet në instrumente financiare me rrezik më të lartë për shkak të realizimit të kthimit më të lartë nga investimet, megjithatë në pajtim me tolerancën e rrezikut të përcaktuar me këtë politikë. Në kuadër të portofolit të investimeve, një pjesë e caktuar e letrave me vlerë mund të klasifikohen si letra me vlerë të ruajtura deri në maturim. Shuma më e lartë e lejuar dhe maturimi i këtyre letrave me vlerë përcaktohen në Rregullat për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore, dhe duke pasur parasysh nivelin e rezervave valutore në raport me nivelin adekuat të rezervave valutore të vlerësuar nga Banka Popullore."

Pas paragrafit 4 shtohet paragraf i ri 5 i cili thotë:

"Pa u dëmtuar funksionimi i secilit prej portofoleve, me instrumentet financiare në kuadër të tyre mund të menaxhohet sipas tre modeleve afariste që të sigurohen hyrje monetare dhe të menaxhohet me rreziqet financiare. Në varësi të modelit afarist, instrumentet financiare mund të ruhen për shkak të ngarkesës së rrjedhave monetare kontraktuale, gjegjësisht për të ruajtur normë të caktuar të kthimit; për shkak të tregtimit aktiv dhe të shpeshtë për të realizuar fitimin nga ndryshimet në vlerën e tregut të instrumenteve; ose për shkak të faturimit të rrjedhave monetare kontraktuale me mundësi të realizimit të fitimit nga ndryshimet në vlerën e tregut të instrumenteve."

Paragrafët 5 dhe 6 mbesin paragrafët 6 dhe 7.

Paragrafi 6 ndryshohet dhe thotë:

“Kriteret për përcaktimin e nivelit të portofolit, llojet e instrumenteve të lejuara, maturimi maksimal, klasifikimi i aktiveve financiare sipas modeleve të zgjedhura afariste, si dhe portofolet referencë përcaktohen në Rregullat për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore. Niveli i portofolit të likuiditetit dhe investimeve rishikohet në mënyrë periodike bazuar në parashikim e nevojave për likuiditet, nevojat e pritshme valutore të vendit në periudhën afatmesme dhe vlerësimin e cënueshmërisë së bilancit të pagesave.

3. Kjo politikë hyn në fuqi me ditën e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

P nr.02-15/IX-1/2022
6 qershor 2022
Shkup

Guvernator
dhe kryesues
i Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
д-р Анита Ангеловска-Бежоска